



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

Objekti: Shërbime Organizimi të Eventeve Sportive (CPV – 92622000-7)

Tabela e Përmbajtjes

***Terma Reference për Organizim Event Sportiv të organizuara nga "Ekipet Sportive në Shkollë"
Promovim ngjarje sportive për Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) në të gjithë vendin.***

Ref: Shërbime Rekreative Kulturore dhe Sportive

1. Rreth KOKSH	2
2. Rreth shërbimit të kërkuar	2
3. Cfarë duam të arrijmë nëpërmjet këtij bashkëpunimi	4
4. Metodologjia dhe plani i punës	3
5. Kualifikimet e nevojshme	3
6. Procesi i aplikimit	4
7. Dorëzimi i ofertave	5
8. Afati i Aplikimit	6
9. Procesi i Vlersimit	6
10. Informacion nëse është përdorur njoftim paraprak	6



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

1. Rreth KOKSH

KOKSH është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj.

KOKSH është pjesë e Lëvizjes Olimpike dhe angazhohet plotësisht të respektojë Kartën Olimpike dhe Kodin Antidoping të Lëvizjes Olimpike, si dhe të jetë konform me vendimet e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar dhe legjislacionin e shtetit Shqiptar.

2. Objekti i shërbimit të kërkuar: Sherbime organizimi te ngjarjeve sportive dhe kulturore.

Për të përmbushur misionin e organizatës dhe për të shpërndarë frymën Olimpike më tej, KOKSH planifikon të organizojë evente sportive, ndeshjet në bashki, ndeshjet në nivel qarku, dhe ndeshjet finale të përmbylljes së kampionatit për periudhën 15.10.2022 - 15.06.2023 sipas kalendarit të ndeshjeve dhe sipas nevojave për çdo event që do të organizohet.

Kerkohet një individ/ekip/kompani me shërbim të lartë profesional, me eksperience të provuar në shërbimet e kërkuara e që është i interesuar të bashkëpunojë me KOKSH për tu angazhuar në aktivitetet e KOKSH.

Nëpërmjet kësaj thirrje të hapur, KOKSH fton individët/ekipet/kompanitë e interesuara të paraqesin ofertën e tyre sipas specifikimeve të mëposhtme.



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

3. Cfarë duam të arrijmë nëpërmjet këtij bashkëpunimi.

Nr.	Emërtimi	Specifikim Teknik	Njësia	Sasia	Cmim/Njësi	Vlera/Lek	Burimi i Financimit	Kohezgjatja
1	Promovim ngjarje sportive	Realizim promovimi i ngjarjeve sportive.	Event	Sherbimet sipas ofertes me te ulet	4,000,000	4,000,000	Qeveria Shqiptare financim projekti "Ekipet Sportive ne Shkolla".	8 Muaj sipas kalendarit te ndeshjeve te miratura nga Ekipet Sportive

4. Metodologjia dhe plani i punës

Do të kontaktohet indiv/ekip/kompani i cili do të propozojë ofertën me të mirë për kryerjen e promovimit të ngjarjeve sportive. Orientimi do të jepet nga ekipi i KOKSH në lidhje me detyrën/punën për të zhvilluar materialet e promovimit për ngjarjet sportive.

Individ/ekip/kompani do të duhet të njohë mirë ambientet ku do të organizohen ndeshjet.

5. Kualifikimet e nevojshme

Kualifikimet:

- Të ketë të paktën 4 vjet eksperience në fushën e shërbimeve të kërkuara.
- Të ketë eksperiencë të mëparshme për organizimin e eventeve të ngjashme kulturore dhe sportive.
- Të ketë infrastrukturen e nevojshme për organizimin e eventeve të ngjarjeve sportive.
- Të disponojë teknologjinë e nevojshme për këto qëllime.



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

6. Procesi i aplikimit

Për të aplikuar në këtë thirrje kërkohet:

- Oferta Financiare per event.
- NIPT-in e biznesit
- Adresen e sakte.

7. Dorëzimi i ofertave

Për të aplikuar në këtë thirrje ju lutem dërgoni ofertat tuaja në zarf të mbyllur në emër të Sekretarit të Përgjithshëm të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar Z. Gerti Shima, në adresën:

Tirana Olympic Park
Rr. "Liman Kaba"
Tiranë, Shqipëri
P.O. Box 63
Email: secretary.general@nocalbania.org.al

8. Afati i Aplikimit

- Propozimet duhet të dorëzohen në adresën e mësipërme deri në datë 13.10.2022 jo më vonë se ora 16:00.
- Ofertat duhet të dorëzohen në gjuhën Shqipe.

9. Procesi i Vlerësimit

Vlerësimi do të kryhet sipas sistemit të pikezimit si më poshtë vijon:

Përshkrimi	Pesha në vlerësim %
Eksperiencat e punës/CV e firmës/individit	20%
Eksperience në organizim eventesh të ngjashme.	40%
Staf dhe pajisjet teknike të nevojshme për organizimin e eventit.	40%



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

10. Informacion nese eshte perdorur njoftim paraprak.

Nuk eshte perdorur njoftim paraprak ne lidhje me kete lloj sherbimi te kerkuar.